

Korrieri, 12 janar 2005

Intervistë me Kryetarin e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Ambasador Pavel Vacek

Gazetar: Elton Metaj

Në të parën intervistë për shtypin shqiptar, Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Ambasadori Pavel Vacek, sqaron se si u arrit marrëveshja midis Socialistëve dhe Demokratëve për ndryshimet në Kodin Zgjedhor dhe ndarjen e zonave. Cili do të jetë roli i OSBE-së gjatë mandatit të Vacek, kritikën për paraardhësin Lipponen dhe deklaron: “Nuk më vjen keq për asnjë sekondë që jam emëruar në këtë detyrë.”

Në zyrën e tij të vogël, në një nga vilat ku jetonin dikur udhëheqësit komunistë të Shqipërisë, Pavel Vacek ndihet i lehtësuar për arritjen e një marrëveshjeje politike mes Socialistëve dhe Demokratëve për reformën zgjedhore. Pas miratimit në Kuvend të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, gjërat duket se po ecin mirë dhe Ambasadori nga Republika Çeke pranon tashmë të flasë për ditët e vështira të fundvitit të shkuar. “Bisedime të tilla nuk janë kurrë të lehta”, - thotë 43-vjeçari, që është diplomuar për tregtinë e jashtme në Pragë. Diplomati nënvizon se u negociua mes PS-së dhe PD-së për faktin se këto dy parti kanë një shumicë kushtetuese në Kuvend. “Nuk është ko incidencë që këta dy aktorë u morën me një paketë çështjesh -- nga njëra anë reforma zgjedhore dhe, nga ana tjetër, çështja e rihartimit të zonave zgjedhore. Ata vetë i dinë më mirë se kushdo arsyet për të cilat këto dy çështje kanë përbërë një lloj pakete, që u pasqyrua më pas në marrëveshjen e 30 dhjetorit,” shprehet Vacek, në të parën intervistë për shtypin shqiptar që prej mbërritjes së tij në Tiranë në fillim të tetorit 2004. Megjithatë, Ambasadori i OSBE-së në Shqipëri shprehet se nuk i vjen keq për asnjë sekondë që ishte emëruar në këtë detyrë. “Është një sfidë profesionale ta kryesh atë”, - thotë Pavel Vacek.

Korrieri: Si do ta vlerësonit marrëveshjen e arritur midis Partisë Socialiste (PS) dhe Partisë Demokratike (PD) lidhur me Kodin Zgjedhor dhe hartimin e ligjit të ri për zonat zgjedhore?

Ambasadori Vacek: Marrëveshja e arritur midis dy partive, siç pasqyrohet në Protokollin e 30 dhjetorit 2004 i ka hapur, pa dyshim, rrugën një hapi tjetër të rëndësishëm në përgatitjen e zgjedhjeve të këtij viti. Duhet theksuar, gjithashtu, se marrëveshja dypalëshe, siç pasqyrohet në Protokoll, nuk është një qëllim në vetvete. Fakti që janë këto dy parti që kanë arritur marrëveshje lidhur me mënyrën e rihartimit të zonave zgjedhore ka të bëjë, gjithashtu, me një fakt jetësor: që të dyja këto parti kanë një shumicë kushtetuese në Kuvendin Shqiptar. Dhe këta dy aktorë janë, në këtë mënyrë, lojtarët kryesorë në marrëveshjen që është çelësi për suksesin e Kodit Zgjedhor. Dhe, pa dyshim, nuk është ko incidencë që këta dy aktorë u morën me një paketë çështjesh – nga njëra anë reforma zgjedhore, dhe, nga ana tjetër, rihartimi i zonave zgjedhore. Ata vetë i dinë më mirë se kushdo arsyet për të cilat këto dy çështje kanë përbërë një lloj pakete, që u pasqyrua më pas në marrëveshjen e 30 dhjetorit. Do të dëshiroja të theksoja edhe se, në

përpjekjet tona ndërmjetësuese, ne kemi respektuar vetëm qëndrimin dhe logjikën e ndjekur nga dy aktorët politikë. Unë do të theksoja edhe natyrën ndërmjetësuese të punës sonë, sepse ne nuk jemi këtu për të diktuar. Ne jemi këtu për të siguruar që, në të gjithë punën për reformimin e Kodit Zgjedhor dhe përgatitjen e zgjedhjeve, respektohen deri në maksimumin e mundshëm standardet ndërkombëtare për zgjedhjet.

Korrieri: Sa e vështirë ishte për ju të negocionit midis dy partive për arritjen e marrëveshjes, duke pasur parasysh dështimin nga ana e Kuvendit për miratimin e ndryshimeve të Kodit Zgjedhor nga fundi i dhjetorit të vitit të kaluar?

Vacek: Pa dyshim, është shumë e qartë për çdo vëzhgues të skenës politike shqiptare që bisedime të tilla nuk janë kurrë të lehta. Lidhur me punën tonë ndërmjetësuese, unë mendoj se momenti më i rëndësishëm ishte kur të dy partnerët kuptuan se duhet të gjenin një gjuhë të përbashkët në lidhje me punën e ardhshme për rihartimin e zonave zgjedhore. Dhe gjuha e përbashkët që u arrit në bisedimet joformale që ne ndërmjetësuam është përfaqësuar nga Kodi i Praktikave të Mira i Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës. Sapo kjo gjuhë e përbashkët u gjet, dhe, në lidhje me zonat zgjedhore, kjo gjuhë e përbashkët u pasqyrua në nenin 4 të Protokollit, ajo që mbeti më pas ishte thjesht një çështje rregullimi detajesh. Ishte po kaq e rëndësishme për të dy partnerët që të kuptonin se objektivi i përgjithshëm i punës për rihartimin e zonave zgjedhore ishte deri diku përcaktimi i shifrave të përafërta më të mira të mundshme të votuesve aktualë në zonat përkatëse. Komponenti tjetër parimor i marrëveshjes së 30 dhjetorit ka lidhje me nevojën për një kalim të shpejtë të ndryshimeve tashmë të përgatitura të Kodit Zgjedhor. Këto ndryshime u përgatitën në dhjetor 2004, ndërsa marrëveshja e 30 dhjetorit konfirmoi vullnetin e palëve për të synuar një kalim sa më të shpejtë të mundshëm të ndryshimeve në Kuvend, gjë që ndodhi ditën e hënë.

Korrieri: Ishte pikërisht ditën e hënë kur pati disa deklarata të ashpra nga disa parti të vogla, si për shembull Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) e ish-Kryeministrit Ilir Meta. Ata ndihen të përjashtuar dhe pretendojnë se zgjedhjet janë shkelur që pa filluar. Cili do të ishte komenti juaj lidhur me këtë deklaratë?

Ambasadori Vacek: Ne jemi në dijeni të këtyre kritikave. Unë mendoj se ato iu drejtohen së pari dy partive të mëdha politike. Në këtë drejtim, ne kemi qenë gjithmonë në favor të një konsensusi sa më të gjerë të mundshëm në skenën politike shqiptare. Si LSI-ja, ashtu edhe Lëvizja për Zhvillim Kombëtar (LZhK) janë të ndërgjegjshme për përpjekjet tona ndërmjetësuese në këtë drejtim. Unë mund të them vetëm se këto kërkesa janë përballur me mungesën e vullnetit nga ana e partive kryesore politike. Megjithatë, duhet të vë re këtu se numri i partive politike që do të përfaqësohen në komisionet zgjedhore është rritur. Ndryshimet e sapomiratuara të Kodit Zgjedhor e përmbajnë këtë ndryshim të veçantë. Ne po flasim për një rritje të kësaj shifre nga katër në gjashtë parti politike. Kështu që, prirja drejt një pjesëmarrjeje të rritur dhe të larmishme të partive politike në komisionet zgjedhore ekziston. Pse kjo shifër nuk mund të rritet edhe më shumë? Kjo është një pyetje që iu duhet bërë së pari PS-së dhe PD-së.

Korrieri: A mendoni se kjo vjen si rezultat i vullnetit të tyre për ta mbajtur procesin nën kontroll, e kam fjalën për dy partitë politike?

Ambasadori Vacek: Përsëri, kjo është një pyetje për të cilën unë nuk kam përgjigje të mirë. Ajo iu duhet drejtuar, së pari, dy partive politike kryesore. Ajo që mund t'ju them është se di që nuk ka ndonjë standard ndërkombëtar konkret lidhur me pjesëmarrjen e një subjekti politik konkret në punën e komisioneve zgjedhore. Ajo që mund të vëmë re, gjithashtu, është se Kodi Zgjedhor parashikon përfshirjen e vëzhguesve të zgjedhur nga parti individuale politike që kandidojnë në zgjedhje. Ai parashikon, gjithashtu, vëzhgimin nga organizata joqeveritare, shoqëria civile, si dhe nga vëzhgues ndërkombëtarë. Pra, ne mendojmë se garancitë themelore janë përfshirë tashmë në sistemin zgjedhor dhe Kodin Zgjedhor. Që këto garanci edhe mund të përmirësohen, kjo është, gjithashtu, e qartë. Dhe nëse ka vullnet të përbashkët dhe konsensus për forcimin e këtyre garancive përmes pjesëmarrjes së më shumë partive politike në komisionet zgjedhore, ne do të jemi gjithmonë vetëm të kënaqur. Problemi është se nuk ekziston një konsensus i tillë nga ana e atyre që kanë pushtetin për të miratuar ndryshime të tilla.

Korrieri: E keni fjalën për PS-në dhe PD-në?

Ambasadori Vacek: Po, sepse këto janë dy partitë që kanë shumicën kushtetuese, për të mos folur për shumicën e thjeshtë në Kuvend.

Korrieri: Siç thatë edhe ju më parë, ju sapo përfunduat takimin e parë të grupit të ekspertëve për zonat zgjedhore. A jeni optimist për punën e këtij grupi? A mendoni se do të jetë i suksesshëm?

Ambasadori Vacek: Më lejoni të bëj të qartë që takimi i këtij grupi vetëm ka filluar. Unë mora pjesë vetëm në fillimin e përrurimit të tij, në seancën e hapjes së takimit të grupit. Po ju them konkretisht se si ndihem, jam optimist, sepse ekziston një angazhim nga të dy aktorët kryesorë. Angazhimi është pasqyruar në Protokollin e 30 dhjetorit 2004. Ka një afat konkret deri në të cilin ky grup mendohet të japë rezultatin e punës së vet. Kjo u konfirmua edhe nga diskutimet e djeshme të Kuvendit. Pa dyshim, puna do të jetë e vështirë, sepse koha është e kufizuar, por, meqenëse drejtimet e përgjithshme të punës janë dhënë dhe janë marrë tashmë nga pjesëmarrësit, unë duhet të jem optimist. Unë besoj, gjithashtu, se do të kemi mundësinë të përfitojmë nga kontributi i aktorëve të tjerë të interesuar në skenën politike. Me fjalë të tjera, puna për zonat zgjedhore nuk mund të mendohet vetëm si një ndërmarrje dypalëshe.

Korrieri: Sa mendoni ju se do të ndikojnë vonesat në reformën zgjedhore tek zgjedhjet e ardhshme të përgjithshme, duke pasur parasysh që ndryshimet në Kodin Zgjedhor do të miratohen në shkurt, në vend që të miratoheshin vitin e kaluar?

Ambasadori Vacek: Sipas mendimit tonë, kjo gjë, në vetvete, nuk duhet të ndikojë në përgatitjet teknike, sepse puna e grupit të ekspertëve duhet të përfundojë deri më 5 shkurt dhe, më pas, të dorëzohet në Kuvend. Nëse Kuvendi miraton zonat zgjedhore të hartuara rishtas në ligjin specifik përkatës, le të themi, deri nga fundi i shkurtit, atëherë ne jemi

brenda kufirit ligjor prej gjashtë muajsh. Kufiri gjashtëmuajor për të cilin unë po flas buron nga Kodi Zgjedhor. Sipas mënyrës se si ne e kuptojmë, periudha gjashtëmuajore brenda së cilës nuk duhen prekur zonat zgjedhore fillon më 3 mars.

Korrieri: A do të thotë kjo se data e zgjedhjeve nuk do të afrohet siç është kërkuar nga Presidenti i Republikës?

Ambasadori Vacek: Nuk më takon mua ta them këtë. Mënyra se si ne e kuptojmë kufirin gjashtëmuajor ose afatin përtej të cilit nuk duhet të ndryshohen zonat zgjedhore është llogaritur përkundrejt datës së shpërbërjes së Kuvendit. Kjo datë e përfundimit të mandatit të këtij legjislativi është fillimi i shtatorit. Nga ajo datë, mund të deduktohet intervali kohor gjatë të cilit mbahen zgjedhjet. Mund t'ju them se ne kemi vepruar në bazë të hamendësimit se zgjedhjet do të mbahen brenda intervalit që fillon më 3 korrik 2005. Përsëri, mund të thuhet se çdo marrëveshje për ndryshimin e kësaj date, arritur nga përfaqësuesit kushtetuesë apo aktorët politikë, duhet respektuar. Dhe duhet respektuar për aq kohë sa është në përputhje me standardet e përgjithshme ndërkombëtare.

Korrieri: Zbatimi i drejtë i ndryshimeve në Kod ishte, gjithashtu, fokusi i deklaratave të djeshme. Pyetja ime është: nëse data e zgjedhjeve afrohet, a mendoni se ka një interpretim të qëllimshëm negativ të intervalit kohor gjashtëmuajor?

Ambasadori Vacek: Për këtë, unë nuk kam përgjigje të arsyeshme, sepse, kur kërkojmë interpretime të qëllimeve të njerëzve të tjerë, ne do të duhet të fillojmë të flasim konkretisht dhe, ndoshta, nuk ka një mënyrë të dobishme për të marrë pjesë në një debat të tillë, të paktën, jo për mua.

Korrieri: Paraardhësit tuaj janë kritikuar nga disa politikanë për atë që ata e quajnë “ndërhyrje në politikën shqiptare”, duke iu referuar rolit të Prezencës si negociatore në disa marrëveshje. Gjatë kryesimit tuaj të Prezencës, a do të vazhdojë ajo të mbajë të njëjtin qëndrim aktiv për çështjet problematike, duke patur, gjithashtu, në mendje faktin se ju keni sakrifikuar pushimet tuaja për protokollin e dhjetorit të vitit të kaluar?

Ambasadori Vacek: Une jam gjithmonë gati të sakrifikoj pushimet e mia, por nuk ishte kështu në këtë rast. Unë jam këtu për të shërbyer, ndihmuar dhe ndërmjetësuar çdo gjë që mund të ndihmonte në përparimin e reformës zgjedhore dhe përgatitjet e zgjedhjeve, kur flasim konkretisht për zgjedhjet, dhe kjo është gjëja më e rëndësishme. Por le të kalojmë tani në pjesën më të rëndësishme të pyetjes tuaj. Për mua, një qëndrim aktiv apo edhe proaktiv, siç pasqyrohet në punën tonë, nuk ka të bëjë fare me ndërhyrjen. Unë jam zotuar dhe ua theksoj këtë të gjithë bashkëbiseduesve të mi se unë e respektoj gjithmonë sovranitetin e Shqipërisë. E kam theksuar gjithmonë, që kur erdha në tetor 2004, se unë nuk diktoj asgjë përveç standardeve ndërkombëtare që udhëheqin punën tonë. Unë gjithmonë e theksoj se unë dhe Prezenca jemi të gatshëm për të ndihmuar kur na kërkohet kjo gjë. Kështu ka qenë ekzaktësisht në ato raste kur ne kemi ushtruar rolin tonë si ndërmjetësues. Është diçka që nuk mund të lë pa përsëritur se ka qenë gjithmonë me kërkesë të aktorëve politikë që ne kemi luajtur rolin tonë si ndërmjetësues me mirëbesim, apo mbështetës teknikë të proceseve, që, duke e përjashtuar këtë, kanë pronësi krejtësisht

shqiptare. Ndonjëherë, është pak ironike që pikërisht ata që na kritikojnë për dështimin në zgjidhjen e kësaj apo asaj çështjeje na kritikojnë në raste të tjera për ndërhyrje. Por unë mendoj se ky nuk është një fenomen i shpeshtë. Në pjesën më të madhe të rasteve, unë jam ndeshur gjithmonë me një qëndrim të arsyeshëm dhe bashkëpunues.

Korrieri: Jeni këtu prej tre muajsh tashmë. A kanë ndryshuar përshtypjet tuaja për vendin ndërkohë? Nëse do të ktheheshit në kohë, do të zgjidhnit përsëri Shqipërinë, nëse do të mundeshit, apo ndonjë vend tjetër?

Ambasadori Vacek: Mund t'ju them se nuk më vjen keq për asnjë sekondë që jam emëruar në këtë detyrë, sepse është një sfidë profesionale ta kryesh atë. Unë vetëm shpresoj që të vazhdoj të dal me sukses nga kjo sfidë, duke plotësuar pritshmëritë e vendit pritës. Ajo që më pëlqen në mënyrë të veçantë në këtë detyrë është fakti që ne jemi në gjendje të nxisim më tej natyrën bashkëpunuese të marrëdhënieve me Shqipërinë si vend pritës. Kam bërë një sërë lëvizjesh, që kanë patur për qëllim të rrisin karakterin bashkëpunues të punës tonë këtu. Ka një transparencë të plotë në projektet e planifikuara për këtë vit. Ne jemi konsultuar gjerësisht me të gjithë partnerët tanë nga ana e qeverisë dhe institucioneve shqiptare, kështu që, mendoj se Prezenca e OSBE-së në Shqipëri është ajo që mund të thotë pa frikë se është e informuar për projektet e saj të planifikuara po aq sa edhe vendi pritës. Sigurisht, ekziston ambicja e zhvillimit të mëtejshëm dhe kultivimit të kësaj marrëdhënieje. Unë mendoj se ka një mirëkuptim nga ana e përfaqësuesve politikë shqiptarë se puna e Prezencës së OSBE-së është e lidhur ngushtë me ambicjet për integrim të klasës politike. Këtu, po flasim për ambicjet për integrim Euro-atlantik në një kuptim më të gjerë. Dhe ky rol i yni është pasqyruar qartësisht në ndërveprimin, kontaktet për bashkërendim apo të tjera që kemi me organizata ndërkombëtare, me Bashkimin Evropian dhe Komisionin Evropian, apo institucione financiare ndërkombëtare dhe organizata apo agjenci të Kombeve të Bashkuara, apo Këshillin e Evropës, i cili tani po punon me ne përsëri për Grupin e Ekspertëve për Zonat Zgjedhore. Apo le të përmendim më konkretisht bashkërendimin e punës së donatorëve ndërkombëtarë që veprojnë në Shqipëri. Të gjitha këto ndërveprime apo kontakte, pa dyshim, kontribuojnë në mënyrë bashkërenduese në objektivat e Prezencës së OSBE-së dhe, në mënyrë të ndërsjelltë, përforcojnë njëra-tjetrën. Besoj se kjo është mirëkuptuar, së pari, nga ana e qeverisë, por edhe nga ana e një përfaqësimit më të gjerë politik.

Korrieri: Nëse zgjedhjet e vitit 2005 do të konsiderohen të suksesshme, a do të punoni drejt zvogëlimit të veprimtarive të Prezencës në Shqipëri?

Ambasadori Vacek: Ka një grup konkret parametrash apo kriteresh dhe ai është pikërisht mandati i Prezencës, i cili është sfondi përkundrejt të cilit hapësira dhe intensiteti i veprimtarive tona mund të maten. Në këtë kontekst, rezultati i dëshiruar dhe i suksesshëm është një moment i rëndësishëm, por, për mua, ai është momenti më i hershëm pas të cilit ne mund të fillojmë të mendojmë se çfarë mund të bëhet ndryshe, ku mund ta zhvendosim theksin, ku mund t'i drejtojmë burimet. E theksoj, kjo do të bëhet gjithmonë në konsultim të ngushtë me vendin pritës.

Korrieri: Pas vizitës së ish-Kryetarit të Radhës së OSBE-së, Solomon Passy, pati një debat në atë kohë lidhur me veprimtaritë e Prezencës.

Ambasadori Vacek: Ne duhet vazhdimisht të hedhim një sy tek marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Prezencës së Shqipërisë si një mundësi për të shfrytëzuar burimet, burimet e kufizuara të Prezencës së OSBE-së. Kjo do të thotë që ne jemi gjithnjë e më pak të pranishëm këtu për të vëzhguar apo monitoruar, ne jemi më shumë këtu për të shërbyer dhe për të përmbushur kërkesat dhe pritshmëritë e vendit pritës. Në fushat konkrete, siç përcaktohen nga mandati, ka ende shumë punë për të bërë. Nuk është vetëm puna për zgjedhjet. Ka edhe shumë fusha në mandat, ku Prezenca e OSBE-së, edhe me burimet e saj të kufizuara, mund të jetë ende e dobishme për Shqipërinë. Kjo vlen për reformën gjyqësore dhe ndërtimin e kapaciteteve të gjyqësorit. E njëjta gjë vlen për reformën në fushën e pronave, ku legjislacioni kryesor është miratuar tashmë, ndërsa pritet zhvillimi i legjislacionit dytësor dhe zbatimi i tyre para së gjithash. Ne mund të vazhdojmë me mbështetjen për punën e policisë, veçanërisht, kur kjo mbështetje sigurohet në bashkëpunim me aktorë të tjerë ndërkombëtarë, BE-në dhe, konkretisht, PAMECA-n. Këto janë fushat ku ka ende shumë vend për bashkëpunim dhe asistencë të mëtijshme. Lidhur me asistencën, nuk e teproj nëse e them përsëri se ne duam që kjo asistencë të udhëhiqet nga kërkesa për të. Unë gjithmonë theksoj se ne i kemi ftuar homologët tanë shqiptarë në shërbimet përkatëse, ministrinë apo institutionet me të cilat ne punojmë të paraqesin kërkesat e tyre, të na thonë se si do të donin të ishin projektet tona, puna jonë. Ky është ndoshta një theks më i madh që unë solla në Prezencë kur erdha dhe e pohoj se kjo ka qenë ambicja ime profesionale.

“Ne kemi qenë gjithmonë në favor të një konsensusi sa më të gjerë të mundshëm në skenën politike shqiptare. Si LSI-ja, ashtu edhe Lëvizja për Zhvillim Kombëtar (LZhK) janë të ndërgjegjshme për përpjekjet tona ndërmjetësuese në këtë drejtim. Unë mund të them vetëm se këto kërkesa janë përballur me mungesën e vullnetit nga ana e partive kryesore politike.”

“Një qëndrim aktiv apo edhe proaktiv, siç pasqyrohet në punën tonë, nuk ka të bëjë fare me ndërhyrjen. Unë jam zotuar dhe ua theksoj këtë të gjithë bashkëbiseduesve të mi se unë e respektoj gjithmonë sovranitetin e Shqipërisë. Unë kam theksuar gjithmonë, që kur erdha në tetor 2004, se unë nuk diktoj asgjë përveç standardeve ndërkombëtare që udhëheqin punën tonë.”